

FAZA e DYTË e debateve mbi Projekt-Kushtetutën e Kosovës

Kapitulli mbi Marrëdhëniet Ekonomike

Koha dhe vendi: 23 shkurt 2008 / Prishtinë (Hotel Iliria, salla e konferencave, kati i dytë)

Panelist: Iliaz Ramajli

Vërejtjet hyrëse nga Panelistët:

Iliaz Ramajli: Mirëngjes të gjithëve. Më vjen keq që nuk ka shumë pjesëmarrës edhe pse janë ftuar shoqatat e biznesit etj. Kjo pjesë e Kushtetutës nuk ka ndonjë interferim nga pakoja e Ahtisaarit. Kjo pjesë është hartuar për t'iu përshtatur kushteve të Kosovës. Ky debat me grupet profesionale dhe me fokus të bizneseve, ka për qëllim që të diskutohet kjo pjesë e Kushtetutës. Është me rëndësi të thuhet se fillimisht kjo pjesë është punuar nga Grupi për Ekonomi në të cilin kanë marrë pjesë Iliaz Ramajli, Isa Mustafa dhe Nerxhivane Dauti. Më vonë është diskutuar në grupe më të gjëra dhe pastaj në Komisionin Kushtetues.

Dëshiroj të falenderoj ekspertët amerikan për ndihmen, dhe ekspertët nga FMN të cilët kanë shprehur interesim të madh në këtë çështje dhe kanë ofruar konsultime. Kontributi i tyre ka qenë shumë pozitiv.

Draft Kushtetuta jonë nuk e ka strukturën tipike siç e kanë Kushtetutat tjera në regjion. Meqë po nxjerret Kushtetua e fundit në regjion, kemi dashur që të nxjerrim atë që është më moderne. Unë do të doja që të mos fokusohemi vetëm në kapitullin për Ekonomi por edhe çështje tjera si në nenin 120 parimet për marrëdhënie ekonomike, pastaj neni 10, parimet themelore, neni 11 valuta, neni 46 veçanërisht mbrojtja e pronës dhe neni 121, pastaj neni 122 resurset natyrore, pastaj tek Agjencitë e Pavarura si dhe nenin 140 Autoriteti Qendror Bankar..

Si parim themelor me këtë Kushtetutë është hapja e tregut. Prona mbrohet dhe është në përputhje me interesin publik. Ndërkaq, në pjesën për marrëdhënie ekonomike, i kemi dhënë të drejtë investitorëve të huaj. Ndoshta e kemi potencuar më tepër këtë fakt sesa në vendet në regjion. Sepse investoret e huaj (nga përvoja në regjion) kanë dashur që të jenë të përcaktuar si kategori me Kushtetutë. Edhe të drejtat për koncesion dhe pasuritë natyrore janë përcaktuar qartë.

Kur është te valuta, ka pasur shqetësime në lidhje me atë se pse Kosova nuk ka valutë nacionale, dhe pse nuk thuhet decidivisht që Autoriteti Bankar emeton valutën. Në fillim është marrë një vendim politik se në Kosovë (me koncensus) të jetë valuta Euro. Nuk është përcaktuar me Kushtetutë valuta sepse në bisedime me Bashkimin Evropian duhet përcjellur disa rregulla për ta pasur Euron. Prandaj edhe nuk është përcaktuar se cila është ajo valutë.

Këto ishin vërejtjet hyrëse dhe tani shpresoj në kontributin tuaj për të shtuar dhe ndryshuar gjëra në këtë Kushtetutë. Kjo pjesë nuk është e detyruar nga pakoja e Ahtisaarit dhe nuk e pengon atë. Unë besoj se vërejtjet e juaja do të merren në diskutim dhe do të inkorporohen.

Pyetjet / Komentet e Pjesëmarrësve:

ÇËSHITJE TË PËRGJITHSHME: PROCESI I KUSHTETUTËS

1. **Pjesëmarrës:** Kam një vërejtje në nenin 120 – në anglisht është “open market economy”, në shqip “ekonomi e tregut të hapur”, mendoj se duhet të jetë vetëm “ekonomi e tregut”. Për shkak që ky sistem është caktuar edhe me Kornizen Kushtetuese. Tregu i hapur është brenda këtij sistemi, e jo jashtë, dhe normal këtu funksionojnë rregullat e konkurrencës dhe të tjera.

Kërkesë tjetër është në lidhje me dialogun social i cili duhet të parashihet më Kushtetutë dhe normal se do të ketë kërkesa edhe nga partnerët tjerë (mendoj për partnerët social) dhe të cilat janë të njohur me këtë. Edhe ligjet ekzistuese, duke filluar nga Ligji për Oden Ekonomike në nenin 4 dhe 8 e parashohin pjesëmarrjen në dialogun social. Në shumicën e Kushtetueva moderne poashtu është e përcaktuar. Është me rëndësi të përcaktohet me Kushtetutë. Sepse nuk besoj se Qeveria do të nxjerrë ndonjë ligj që do të rregullojë këto çështje. Konsideroj se marrëdhëniet ekonomike duhet të zhvillohen në ekonomi të tregut, solidaritetit dhe partneritetit social, për të krijuar një paqe sociale. Nëse dialogu social do të parashihet me Kushtetutë atëherë të parashihet rregullimi me ligj dhe do të krijohej Këshilli Ekonomik Social. Kjo veç po ndodhë në Unionin Evropian përmes konferencave të para që po organizohen. Unë i kam përgatitur këto dy dokumente dhe besoj se do t'i marrë z. Ramajli për t'i inkuoruar.

Iliaz Ramajli: Sa i përket termit “ekonomi të tregut të hapur” është në të gjitha Kushtetuta e rajonit. Ajo që përmendet në Kornizen Kushtetuese nuk bën përshtypje. Por, kjo pjesë është në të gjitha Kushtetutat. Është në të Shqipërisë, Kroacisë, Maqedonisë, etj. Do ta marrim parasysht. Ky është term Kushtetues.

Dialogu social përmendet në nenin 7 te Vlerat – ku përfshihet drejtësia sociale. Nuk e përfshinë si dialog social por e parasheh si të drejtë. Nëse e bëjmë si kategori, pa i përcaktuar subjektet besoj se ka bazë për diskutim dhe unë do ta prezantoj në Grupin për Ekonomi dhe mandej në Komision. Nuk besoj se do t'i bënte ndonjë dëm të gjithë atyre që janë pjesë e këtij dialogu.

2. **Pjesëmarrës:** Kam disa çështje që dëshiroj shpjegime. Në nenin 46 – Mbrojtja e Pronës – në pikat 2 dhe 3: [Pika 2 – Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në përputhshmëri me interesin publik. Përdorimi i tokës mund të kufizohet për qëllime të zonimit. Zonimi nuk jep të drejtën për kompensim; Pika 3 - Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga prona e vet. Në interes publik, në bazë të ligjit, pronësia mund të ekspropriohehet, me kompensim adekuat dhe të nenjëhershëm]. Dëshiroj shpjegime rreth “zonimit” dhe “kompensimit adekuat”. Mendoj se sa i përket kompenzimit duhet të specifikohet dhe të thuhet “të kompenzohet me vlerën reale të tregut”

Iliaz Ramajli: Neni 46 [pika 2] ka qenë objekt i pyetjeve në çdo takim, dhe bash kjo çështje. Edhe në Komisionin Kushtetues kemi kërkuar shpjegim për këtë. Shpjegimi është se është për zona urbane. Unë do t'i përcjell këto vërjetje për t'u sqaruar. Nëse është fjala për zonat urbane të thuhet, nëse është diçka tjetër të thuhet përsëri, pra të precizohet. Shpjegimi është për zonat urbane por duhet dhënë shpjegim.

Neni 46 [pika 3] po sugjerohet se “kompenzimi adekuat” të zëvendësohet me termin “të përputhet me vlerën e tregut në momentin e aktit të shpalljes se expropriimit”.

3. **Pjesëmarrës:** Pyetje rreth investimeve: Neni 120 pikat 1 dhe 6. Pika 1 [...] “mbron pronën private dhe publike”, por a është e garantuar edhe mbrojtja e investimeve? Ndërsa në pikën 6 “investitorëve të huaj i garantohet nxjerrja e kapitalit” – a do të rregullohet me ligj apo si? Ndërsa pyetja tjetër është rreth donacionave – a do të rregullohet me ligj apo si?

Iliaz Ramajli: Këtu kemi dashur që t'i garantojme investitorëve që të nxjerrin kapitalin nga vendi. Investimet e huaja janë të rregulluara me Ligjin për Investime. Është një prej ligjeve që jep siguri maksimale për investitorët e huaj.

Pika 2 e nenit 120 i jep tretman investimeve të huaja dhe vendore.

Sa i përket donacioneve, kjo është materie ligjore që do të rregullohet me ligj.

4. **Pjesëmarrës:** Si është rregulluar prona publike, në cilin kapitull?. Me krijimin e Agjencionit të Pronës është krijuar një konfuzion se kush është titullar i pronës.

Iliaz Ramajli: Më Kushtetutë rregullohen parimet. Neni 121 kur është shkruar është diskutuar shumë dhe janë konsultuar përvojat e shteteve. Dikund 95% të shteteve e kanë të rregulluar me ligj. Në nenin 121 [të Kushtetuës] thuhet me ligj, dhe aty me ligj pastaj do të përcaktohen cilat janë llojet e pronës, kush është pronari, si mund të përdoret, etj. Nuk jemi përcaktuar që t'i përcaktojmë këto me Kushtetutë. Prona si pronë është rregulluar me Kushtetutë ndërsa tjerat me ligj.

5. **Pjesëmarrës:** Unë kam një kërkesë për sqarime në 2-3 nene. Të sqarohet neni 158 Autoriteti Qendror Bankar ku thuhet “deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare [...] Guvernatori i Republikës së Kosovës do të emërohet nga Presidenti”. Ndërsa në nenin 84 [pika 25] thotë se “Presidenti emëron Guverntorin e Bankës Qendrore [...], i cili do të shërbejë si Drejtor Menaxhues [...]”. Për momentin Banka ka Kryetarin dhe Drejtorin Menaxhues, siç po shihet nuk do të ketë këto dy role!?

Neni 140 pika 3 “Banka Qendrore [...] kompetencë ekskluzive ka promovimin e saktësisë”, çka don të thuhet me “saktësi”?

[Neni 11] Valuta – kjo valutë [Euro] ka kontribuar në ruajtjen e çmimeve dhe jam i mendimit që Euro të inkorporohet si valutë kombëtare në Kosovë.

Emetimi i Euros – e dimë se të gjitha Bankat e shteteve që kanë Euron kanë të drejtë të emetimit. Propozoj që të përcaktohet se Emetimi i Euros bëhet nga Banka Qendrore dhe [kështu] të jetë e barabartë me të gjitha Bankat tjera.

Në Kushtetutë përmendet se emërimi i Guvernatorit bëhet nga Presidenti, ne e dimë se është institucion i pavarur. Propozimin do të duhej ta jep Kryeministri dhe Presidenti, ndërsa të emërohet nga Kuvendi.

Iliaz Ramajli: Kjo është periudha tranzitore – dhe është përcaktuar me pakon e Ahtisaarit. Poashtu edhe në Deklaratën e Pavarësisë janë të numëruara si cilat janë obligimet që i merrë Kosova për t'i zbatuar nga pakoja e Ahtisaarit. Këto janë obligime të marra nga Kosova si shtet. Neni 158 është obligim tekstual që është marrë nga pakoja për t'u zbatuar.

Neni 84 pika 25 – Janë dy forma që qeverisen Bankat Qendrore, përmes Guvernatorit dhe Drejtorit Menaxhues, si dhe kur Drejtori i Bankës është edhe Drejtor Menaxhues. Në këtë pjesë ka pasur diskutim edhe me FMN-në dhe është marrë parasysh edhe përvoja e deritashme e Autoritetit Bankar, dhe është unanimisht një vendim që të jetë e unifikuar një pozitë që të mos ketë probleme me funksionet. Kjo ka dalur nga Grupi për Ekonomi, një grup tjetër, por është diskutuar edhe në grupin e Komisionit Kushtetues. Ne jemi përcaktuar që një person të ketë të dy pozitat.

Neni 140 pika 3 – “promovimi i saktësisë”. Gjuhësisht është vështirë të shpjegohet. Unë do ta përcjell këtë në Komision. Ndoshta mund të ketë shpjegim, por vërejtja është me vend që të

shpjegohet se çka do të thotë. Mendoj se duhet sqaruar.

6. **Pjesëmarrës:** Neni 84 pika 25 termi “drejtor menaxhues” – të përdoret “drejtor i përgjithshëm” sepse është një fjalë. Të përdoret “drejtor i përgjithshëm” propozoj.

Iliaz Ramajli: Ndoshta gjuhësisht duhet shquar. Edhe në anglisht është “drejtor” dhe “director”. Këtu ka pozita dhe drejtorë tjerë. Ndoshta në shqip kemi probleme, për shkak se ne nuk e kemi zbuluar, por drejtori menaxhues i bën aktivitetet ditore. Jepini sugjerimet dhe do ta diskutojmë. Pajtohem se këto duhet diskutuar.

7. **Pjesëmarrës:** Çfarë mekanizimi ka që ju obligon t’i merrni parasysh këto vërejtje?

Iliaz Ramajli: Pas përfundimit të debatëve me 1 mars, të gjitha vërejtjet do t’i prezantohen grupeve punuese. Nuk e kanë obligim me i shqyrtu por do t’i marrin parasysh. Unë ju garantoj që për Grupin për Ekonomi do të shqyrtohen dhe analizohen me shumë kujdes. Nuk janë vetëm vërejtje por edhe ofrohen zgjidhje. Ato që i pranon grupi do të shkojnë te Komisioni Kushtetues si tekst i spastruar. Ka vërejtje që mund të përfshihen. Unë besoj se vërejtjet nga ODA, janë vërejtje që janë akumuluar prej bizneseve dhe nuk janë vërejtje personale.

8. **Pjesëmarrës:** Jemi dëshmitar të eksploatimit të tokës urbane dhe bujqësore. Ndërtimi i objekteve në tokë bujqësore. Për shembull në Slloveni nuk mundet me ndërto objekt në tokë bujqësore pa vendim të gjykatës. Të gjendet mënyra se si bëhen ndryshimet e tokës nga bujqësore ne urbane dhe të përcaktohet me Kushtetutë.

Iliaz Ramajli: Materien që ju prekët është materie ligjore. Edhe ligji në Kosovë e parashikon atë që është në Slloveni, pse nuk zbatohet është diçka tjetër. Dhe ky ligj rregullon ndërrimin nga toka bujqësore në urbane.

9. **Pjesëmarrës:** Në disa raste është përdorur në përputhje me “ligjin”. Neni 120 pika 7 “garantohet mbrojtja e konsumatërove e paraprë me ligjin”, ndërsa pika tjetër thotë me “ligj”, pse është bërë kjo?. Nuk ka nevojë të thuhet ajo që nënkuptohet!?

Iliaz Ramajli: Mund të jetë përvjedhur ndonjë gabim në terminologji, por nuk është se njerëzit që kanë punuar nuk janë ekspert. Tek tatimet p.sh., vetëm ajo që është paraparë me ligj dhe asgjë tjetër. Është një fakt që pranohet se teksti nuk është më i mirë as në tekst as në zgjidhje. Do të ishte më mirë të diskutohej për një vit me publikun. Është një vendim që deri në mars duhet ta kemi Kushtetutën.

10. **Pjesëmarrës:** Neni 120 [...] “siguron bashkëpunim të brendshëm dhe të jashtëm”, kush janë akterët?. Kush janë faktorët?

Iliaz Ramajli: Masat duhet përcaktuar. Ka pasur edhe vërejtje tjera. Kjo duhet rregulluar me masa të brendshme dhe përmes marrëveshjeve ndërkomëbtare. Do të duhej të ishte me masa.

11. **Pjesëmarrës:** A mundet dikush ta qartësoj se çka kuptoni me dialogun social?.

Pjesëmarrës: Dialogu social nënkupton të gjitha llojet e negociatëve, dialogjeve dhe shkëmbimit të informatave në mes Qeverisë, punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Pjesëmarrës: Çka po propozoni - mekanizëm?

Pjesëmarrës: Po

Pjesëmarrës: Kushtetuta vë parimet, dhe këto janë parime udhëzuese dhe ka shumë gjëra që mund të rregullohen me ligje dhe që janë më specifike. Të gjithë ju që jeni pjesë e Odes, është një mision i ardhshëm i juaji që të siguroheni që këto gjëra të bëhen pjesë e ligjeve, dhe të merrni pjesë në hartim dhe implementim.